

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

Veprimtarite e lendes se drurit

ID 7.10/b “Përvec rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj shtojce, prodhimi i produkteve të perbera tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s, veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, ferkimin me rere, gdhendje, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit.”
(sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)

SUBJEKTI: “SANA” Sh.p.k.

NIPT: L18609302K

VENDNDODHJA: Lezhe Milot Shullaz, Fshati Shullaz, Rruga Kryesore, Ndertese 1 Kateshe, Zona Kadastrale nr.3441, me pasuri nr.118/4.

1. PROFILI I OPERATORIT

Subjekti “SANA” Sh.p.k. është i regjistruar në Qendren Kombëtare të Biznesit, NIPT L18609302K, me përfaqësues ligjor Petrit SANA.

Operatori ushtron aktivitetin në vendndodhjen **Lezhe Milot SHULLAZ Fshati Shullaz, Rruga Kryesore, Ndertese 1 kateshe, Zona Kadastrale nr.3441, me pasuri nr.118/4**, me aktivitet **ID 7.10/b** *“Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kesaj shtojce, prodhimi i produkteve të perbera tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s, veprimtaria përfshin:sharrimin, shpimin, ferkimin me rere, gdhendje, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit”*.

Subjekti në fjalë është i pajisur me Leje Mjedisi tipi C dhe në zbatim të dispozitave ligjore , përkatësisht Ligjit Nr. 52/2020 datë 30.04.2020 për një ndryshim në Ligjin 10448 “Për Lejet e Mjedisit” do të kryejë procedurën e kalimit nga Leje Mjedisi tipi C në Leje Mjedisi tipi B.

2. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

Objektivi i parë i këtij aktiviteti do të jetë të identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore këtij instalime të cilat janë:

- Emetimet në ajër dhe zhurmat;
- Ndikimi në flore/faunë;
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
- Ndikime social-ekonomike;
- Ndikim në cilësinë e jetes në qendrat e banuara;
- Ndikim në rritjen e trafikut rrugor;
- Ndikim në peizazhin e zonës;

-Objektivi i dytë i këtij aktiviteti është gjetja e alternativave që janë më miqësore me mjedisin.

3. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT

Vendndodhja e aktivitetit eshte: **Lezhe Milot SHULLAZ Fshati Shullaz, Rruga Kryesore, Ndertese 1 kateshe, Zona Kadastrale nr.3441, me pasuri nr.118/4**

Siperfaqja ne te cilen do te zhvillohet aktiviteti ne adresen e sipercituar do te jete e kufizuar sipas koordinatave te meposhteme dhe hartes:



Koordinatat e trullit se subjektit "SANA" Sh.p.k		
Nr	X	Y
1	4392224	4614515.93
2	4392283.23	4614476.57
3	4392264.59	4614452.82
4	4392249.78	4614423.28
5	4392200.98	4614436.22
6	4392202.41	4614466.08

Koordinatat e godines se subjektit "SANA" Sh.p.k		
Nr	X	Y
1	4392233.94	4614507.74
2	4392238.12	4614505.36
3	4392217.14	4614467.64
4	4392211.73	4614470.5

4. PERSHKRIMI AKTIVITETIT

ID 7.10/b “Pervec rasteve te permendura ne kategori te tjera te kesaj shtpje, prodhimi i produkteve te perbera tersisht apo kryesisht nga druri n.q.s, veprimtaria perfshin: sharrimin, shpimin, ferkimin me rere, gdhendje, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik te drurit”.

Pajisjet qe perdoren ne funksion te aktivitetit:

1. *Trapano dore*
2. *Sharre dore*
3. *Çekiç*
4. *Gozhda te madhesive te ndryshme*
5. *Meter*
6. *Kaçavida*





Aktiviteti ne fjale nuk eshte nje aktivitet prodhimi i cili perdor makineri apo kryen procese te cilat gjenerojne ne mjedis komponente ndotes. Procesi ne kete aktivitet konsiston ne ndertimin e paletave te drurit, nga ristelat te cilat perdoren gjeresisht nga industrite e prodhimit per vendosjen e mallrave te ndryshme.


Ne shoqerine tregtare “SANA” SH.P.K, ristelat sillen nga furnitore te ndryshem. Pas pranimit te tyre nga personi pergjegjes dhe likuidimit te tyre magazinohen ne vendin e depozitimit input.

Pas procesit te vendosjen ne vendin e percatuar ristelat ne forme drejtkendore, kalon ne procesin e montimit te tyre. Procesi i montimit eshte nje proces i thjeshte i cili realizohet

totalisht mekanikisht pa perdorimin e makinerive apo pajisjeve. Montimi realizohet nga punonjesit e aktivitetit fillimisht duke i pershtatur ne gjatesine standarte te paletave dhe me pas duke perdorur mjete mekanike te tipit gozhde, trapano dhe sharre dore montohen ne forme katrore ne madhesite e kerkuara. Ky lloj procesi shoqerohet pa mbetje sepse cdo pjese e prere perdoret ne paleta te tjera te cilat jane ne madhesi me te vogla. Gjithashtu edhe nga procesi i prerjes me sharre dore nuk kemi gjenerim te mbetjeve sepse pritet ne copa te medha.

Pas montimit mekanik ne formen dhe madhesine e kerkuar paletat vendosen ne nje ambient te maganizes per tu shitur ne klientet porositet apo kerkues.

SKEMA E REALIZIMIT TE PUNES



5. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMIT I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Rrezatimi Jonizues

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi rrezatime jonizuese.

Vibracionet

Funksionimi i aktivitetit gjeneron vibrime shume te lehta vetem ne rastet kur mjetet e transportit sjellin lenden e pare, e cila ndodh vetem ne harqe kohore te shkurtra, gjithashtu edhe ne momentin kur furnizohen mjete te renda. Keto vibrime jane shume te lehta, nuk ndikojne negativisht ne mjedisin e zones, shqetesimin e banoreve apo bizneseve qe ndodhen ne afersi te aktivitetit.

Ndikimet ne popullsi

Zhvillimi I aktivitetit nga subjekti “SANA” sh.p.k nuk do te kete ndikime ne popullesi. Edhe pse aktiviteti eshte I pozicionuar ne nje zone urbane, ne kufizimet e tij zhvillohen aktivite te regjetare te ndryshme. Natyra e ketij aktiviteti nuk shoqerohet me shkarkime ne uje, ajer dhe toke qe mund te cenojne shendetin e banoreve apo bizneseve te ndodhura aty prane.

Ndikimet ne toke

Zhvillimi i aktivitetit nuk shoqerohet me shkarkime ne toke, rrjedhimisht nuk kemi as ndikime negative ne toke. Aktiviteti zhvillohet ne zone te mbyllur dhe procesi i punes nuk ka ndikime te tilla.

Mbetjet e ngurta

Mbetjet e ngurta qe dalin si rezultat i aktivitetit te punonjesve do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga shoqeria dhe me pas do te dergohen per ne vendet e caktuara nga pushteti vendor. Kompania do te punoje per ndarjen e tyre qe ne vendburim, nepermjet konteniereve me ngjyra.

Ndikimet ne ajer

Referuar natyres se aktivitetit mund te kemi kemi ndikime minimale negative ne ajer. Clirime minimale ne ajer, mund te kemi vetem ne momentin e ndezjes se mjeteve gjate sjelljes se lendes se pare ne subjekt megjithate ne pikepamjen mjedisore dhe shendetesore keto ndikime mund te konsiderohen te paperfillshme.

Ndikimet ne ujera

Funksionimi i aktivitetit nuk do te kete ndikime ne ujera. Ne ujra do te kemi vetem shkarkimin nga nyjet sanitare ne rrjetin e zones. Ujra te gjeneruara nga larja e aktivitetit nuk do te kemi. Gjithashtu zhvillimi i ketij aktiviteti nuk cenon cilesine e burimeve ujore siperfaqesore dhe nentoksesore.

Ndikimet ne klime

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

Ndikimet ne floren dhe faunen

Zona në te cilen ushtrohet aktiviteti është një zonë urbane dhe nuk mund te analizojme ndikime ne flore dhe faun. Operatori do te shtoje siperfaqet e gjelberta per nje pamje vizuale me te kenaqshme per syrin dhe per te mirat ne pikepamjen mjedisore. Gjithashtu zona karakterizohet nga bimesi e zhveshur dhe nuk takon elemente te spikatur faunatik dhe fluoristik.

Ndikimet nga zhurmat

Zona ne te cilen zhvillohet aktiviteti ben pjese ne zone urbane. Aktiviteti ndodhet ne ane te rruges kryesore te Lacit. Nga zhvillimi I aktivitetit nuk ka shkarkime te zhurmave dhe nga funksionimi I aktivitetit nuk pritet te kete rritje te nivelit te zhurmave, aq me teper ndikime negative ne kete prizem.

Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportin

Infrastruktura ne te gjithe perimetrin e aktivitetit eshte e shtruar gjithashtu edhe rruga kryesore qe kalon prane aktivitetit. Nuk pritet qe te kete ndikime negative apo ndryshime te infrastruktures.

Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike historike dhe zonat e mbrojtura

Aktiviteti që ushtron shoqeria ndodhet në një zonë në sipërfaqen e së ciles dhe në nëntokën e saj nuk ka ndertime lidhur me trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore. Kjo tregon që zona është zonë e lirë jo vetëm për të realizuar kete aktivitet. Gjithashtu edhe ne afersi te zones nuk ndodhen zona te mbrojtura apo trashigimi kulturore dhe natyrore.

Ndikime ne rrjetin hidrografik

Natyra e aktivitetit nuk kerkon perdorim te ujit. Perdorimi i ujit qe do perdoret per nyjet sanitare do te meret nga rrjeti dhe do te shkarkohet po ne rrjetin e zones per tu menaxhuar me pas nga Ujesjelles Kanalizime e zones.

Ndikimi social-ekonomik

Me operimin e ketij aktiviteti pritet te kete nje impakt pozitiv ne ekonomine e vendit, ne aspektin e punesimit te individeve te zones, padyshim dhe per pushtetin vendor si pasoje e taksave qe operatori pagan.

6. MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT NGA NDIKIMET NEGATIVE

Mjedisi i ndikuar	Propozime
Toka	<ul style="list-style-type: none">➤ Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave te percaktuara➤ Zbatimi i kushteve teknike dhe standarteve➤ Pastrim i ambientit te punes➤ Mirmbajtja dhe gjelberimi i siperfaqes
Biodiversiteti	<ul style="list-style-type: none">➤ Mbjellja e fidaneve te rinj, pergjate rruges qe ben te mundur hyrjen per ne objekt apo edhe brenda tij
Cilesia e Ajrit	<ul style="list-style-type: none">➤ Gjate kohes se ardhjes se mjeteve qe sjellin lenden e pare do te fiken qe ne momentin e mberritjes ne subjekt per te mos shkaktuar emetime ne ajer.
Mbetjet urbane nga aktiviteti i punonjësve që do të operojnë	<ul style="list-style-type: none">➤ Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitimim më të afërt të caktuar nga njësi vendore.
Zhurmat	<ul style="list-style-type: none">➤ Detyrimi i fikjes se automjeteve, si per sigurine ashtu edhe per uljen e gjenerimit te zhurmes.➤ Vendosja e tabelave ne hyrje te instalimit, se nuk lejohet levizja e shpejte e makinave ne subjekt dhe ne afersi te tij.
Trafiku rrugor Fluksit te qarkullimit	<ul style="list-style-type: none">➤ Orinetimi I mjeteve qe ne hyrje te subjektit.➤ Sigurimi I lendes se pare ne subjekt ne orare ku te shmanget piku I trafikut.

ADMINISTRATORI

Petrit Sana